



Vodhën 40 mijë euro dhe ari në vlerë 25 mijë euro nga një shtëpi në Ferizaj, Policia arreston një prej të dyshuarve



28/03/2023 07:46

f

t

l

Policia e Kosovës ka arrestuar një person të dyshimtë për vjedhje të rëndë në Ferizaj.

Rasti kishte ndodhur më 18.03.2023 rreth orës 04:00 në një shtëpi banimi në fshatin Greme të Ferizajt, ku persona të panjohur kanë depërtuar me forcë dhe nga aty dyshohet se kanë vjedhur para në vlerë prej 40 mijë euro, stoli ari në vlerë prej 25 mijë euro dhe dy armë zjarri (pistoleta) me leje dhe sasi municioni.

“Sektori Rajonal i Hetimeve nga Drejtoria Rajonale e Policisë në Ferizaj, nën autorizim të prokurorit nga Prokuroria Themelore në Ferizaj i kishte marr të gjitha veprimet e nevojshme dhe kishte nisur hetimet. Hetuesit rajonal pas një punëve intenzive, grumbullimit të informacioneve në terren, shikimit të kamerave të sigurisë, kanë arritur që të sigurojnë prova të mjaftueshme dhe me datën 27.03.2023 rreth orës 19:30 kanë arrestuar të dyshuarin S.I (M/K) i moshës 49 vjeçar, i cili dyshohet se ka kryer vjedhje të rëndë”,thuhet në njoftim, transmeton lajmi.net.

I dyshuari S.I është shoqëruar në Sektorin Rajonal të Hetimeve në Ferizaj dhe pas intervistimit të tij, në prani të avokatit mbrojtës, me vendim të prokurorit të rastit është ndaluar në mbajtje për 48 orë, për procedura të mëtejme hetimore./Lajmi.net/

Artikuj të ngjashëm



March 28, 2023

KGjK dhe Komuna e Prishtinës nënshkruajnë memorandum bashkëpunimi



March 28, 2023

Lirohet ish-dhëndrri i rojes që mbeti i vrarë në sulmin me...



March 28, 2023

Hoxha: Marshi s’është politik por mbështetje për krerët në Hagë, vendimet...



March 28, 2023

Lajçak bisedon për dialogun Kosovë-Serbi me eurodeputetin slllovak



March 28, 2023

Vdes papritur një person në Klinë, Policia po e heton rastin



March 28, 2023

Arrestohen pesë persona në Viti, po kontrabandonin duhan

LAJME TË FUNDIT



KGjK dhe Komuna e Prishtinës nënshkruajnë memorandum bashkëpunimi



Lirohet ish-dhëndrri i rojes që mbeti i vrarë...



Hoxha: Marshi s’është politik por mbështetje për krerët...



Calhanoglu arrin marrëveshje për rinovim me Interin